



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli, në mungesë, aktin e relaton znj. Shehu) për:

1.1 Kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit;

1.2 Kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
6. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Fatmira Luli, në mungesë, aktin e relaton znj. Shehu*) për:

1.1 Kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të *znj. {...}* për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit;

1.2 Kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të *znj. {...}* për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Naureda Llagami: Fillojmë mbledhjen plenare të datës 28 shtator.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot kërkohet vendimmarrja nga ana e Këshillit për 10 çështje.

Nëse nuk kemi diskutime mbi rendin e ditës, po fillojmë me çështjen e parë.

Në çështjen e parë janë dy projekt-akte që vijnë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, që kanë të bëjnë me kualifikimin për emërim në shërbimin civil të dy ndihmësve ligjore të cilat kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe i janë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vijuar procedurat e emërimit të tyre.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatores znj. Shehu për të dy projekt-aktet.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Sikurse ju e cituat, Komisioni i Administrimit dhe i Planifikimit Strategjik ka përgatitur dy projektvendime për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit dhe për zonjën {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur ndër të tjera në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 213, datë 16.06.2022, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor, vitin akademik 2022-2023” si dhe në vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe mbasi ka konsideruar gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës, ka vendosur për 2 kandidatet fituese si më poshtë:

Me vendimin nr. 527, datë 06.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës fituese znj.{...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor;

Me vendimin nr. 543, datë 14.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës fituese znj.{...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor.

Të dyja kandidatet e mësipërme kanë përfunduar me sukses programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor viti akademik 2022-2023 në Shkollën e Magjistraturës.

Në kreun VII, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor” parashikohet ndër të tjera, se për kandidatët që kanë përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, duhet t’i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil.

Me shkresën nr. 546 prot., datë 21.07.2023, shkolla ka përcjellë vendimin e saj me nr. 30, datë 18.07.2023, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Konform dispozita të vendimit nr. 424/2020, Këshilli ka përcaktuar se jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për këshilltarë/ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës, disponohet në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit së tyre.

Në këtë moment, nga ana e relatores dhe Komisionit janë verifikuar kushtet formale të pranimit në shërbimin civil, konkretisht si për zonjën {...} ashtu edhe për zonjën {...} janë verifikuar kushtet dhe kriteret që parashikohen në ligjin 98/2016 si dhe në nenin 21 të ligjit 152/2013 si më poshtë:

Të jetë shtetas shqiptar; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë që të kryejë detyrën përkatëse; të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur; të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; të mos jenë marrë masa disiplinore të largimit nga shërbimi civil që nuk është shuar sipas ligjit. Për të dyja këto kandidate rezulton se plotësohen kriteret formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Bazuar sa më sipër, për të dyja kandidatet është i njëjti konkluzion. Plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësin civil gjyqësor në kategorinë e ndihmësit ligjor; kanë përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës dhe janë kualifikuar mbi procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës.

Bazuar në sa më sipër ju janë vënë në dispozicion edhe dy projektvendime, të

cilat titullohen: Për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe të znj. {...}.

Në pikën 1 parashikohet kualifikimi dhe vijimi i procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor i secilës prej kandidateve në pozicionin e ndihmësit ligjor.

Paraqiten të dy projektvendimet për miratim.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu!

Atëherë kalojmë në hedhjen në votim të projekt-aktit të parë që ka të bëjë me kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 14, procedurën e lëvizjes paralele

në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 14, kandidoi edhe z. {...} me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Për pozicionin e shpallur me vendimin 14/2023, Këshilli me vendimin nr. 344, datë 27.06.2023 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.14, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga ky pozicion”.

Këshilli me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim. Dhe u caktua për kandidatin z. {...} si relator z. Klodian Kurushi.

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit.

Për z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

“Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 14/2023, si dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 14/2023, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014 dhe ushtron detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Gjirokastër prej shtatorit të vitit 2014.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në vitin 2006 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekret të Presidentit të Republikës të vitit 2013 caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin e vitit 2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër të vitit 2019 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 22.04.2022.

Me vendim nr. 225, datë 20.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një periudhë deri më datë 20.06.2023.

Me vendim nr. 49/2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Gjirokastër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm

Gjirokastrë, rezulton se: "...Natyra e çështjeve që ka gjykuar janë çështje të karakterit civil, penal, familjar prej periudhës 25.09.2015 dhe në vijimësi.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 (nëntë) vite.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 14, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për z. {...} u verifikua edhe kriteri i "mospasjes masë disiplinore në fuqi".

Nga dokumentacioni dhe verifikimi i bërë ka rezultuar se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për z. {...} u verifikua edhe kriteri i "papajtueshmërisë ambientale".

Në bazë të verifikimeve dhe nga dokumentacioni i administruar, për z {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Këto janë të gjitha verifikimet e bëra për zotin {...} dhe ne propozojmë kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e mëtejshëm të procedurës për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.14 të vitit 2023. Faleminderit!

Naureda Llagami: Jemi dakord? Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që edhe ky ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Relator është zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me disa vendime të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 18.01.2023, janë hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 24, është hapur procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Është përcaktuar afati i kandidimit që ishte data 1.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, znj. {...}.

Rezulton se në pozicionin e shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023 nuk ka kandidatë të mundshëm me 2 vlerësime për të vijuar konkurrimin. Në rrethanat si më sipër, Këshillit i duhet që të fillojë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – pozicioni nr. 24, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Për këtë arsye është bërë shortimi, është caktuar relatori dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale, pra është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit, të caktimit të relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar apo dhe të ndonjë anëtarit të Këshillit.

Brenda afatit, kandidatja nuk ka parashtruar ndonjë pretendim për sa më sipër, duke vijuar pra Këshilli me procedurat e verifikimit, që kryesisht kanë të bëjnë me verifikimin e pasjes së “përvojës profesionale minimale specifike” atë të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, si dhe të kriterit të tretë që ka të bëjë me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

Këshilli i ka kërkuar dokumentacion Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, nga e cila rezulton që znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 20.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Me vendim nr. 127, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare.

Me vendim nr. 151, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më datë 22.04.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e

Zv/Kryetares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, nga verifikimet e kryera, pranë gjykatës ndodhen të administruara urdhrat me shkrim ndër vite të kryetarit të gjykatës sa i përket formimit të trupave gjykues të gjyqtarëve prej vitit 2019. Sipas informacionit të ngarkesës vjetore të gjyqtarëve të përcjellë, për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, rezulton se znj. {...} ka gjykuar çështje penale dhe civile: “...Natyra e çështjeve që ka gjykuar janë çështje të karakterit civil, penal, familjar prej periudhës 30.07.2019 dhe në vijim. Gjithashtu ka qenë gjyqtare e cila ka gjykuar edhe çështje në seksionin e te miturve. Vlen të theksohet fakti për vitin 2022 gjyqtare {...} ka gjykuar një numër të lartë çështjesh për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër kishte në përbërje vetëm 2 gjyqtarë për një periudhë kohore me shumë se 6 muaj...”

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit për kandidaten është 4 (katër) vite.

Pra rezulton nga të dhënat që kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 24, datë 18.01.2023, të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Veç formularit të vetëdeklarimit dhe nga informacioni i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton që kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Se çfarë përfaqëson papajtueshmëria ambientale është përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 24/2023, si dhe në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin. Në vijim të verifikimeve të kryera rezulton që nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit

për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet që të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në këto kushte, relatori ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, më datë 19.09.2023, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, vlerëson për kualifikimin e kandidates {...} pasi nuk ndodhemi në asnjë nga kushtet e përjashtimit të saj ky kandidim.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votim të projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}. Për më shumë detaje, zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju paraqes në mënyrë të përmblodhur relacionin për sa i përket projektvendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e gradimit për gjyqtaren {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 ka detyrimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka kaluar vetting-un është edhe znj. {...}, e cila nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është dorëzuar dosja pranë KLGJ-së.

Pas verifikimit paraprak të bërë nga Komisioni i Vlerësimit Etik është konstatuar se gjatë periudhës së vlerësimit (gradimi), konkretisht ka rezultuar se nga periudha tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, konkretisht nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin e Presidentit të datës 23.06.2016 ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kështu rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtarës gjatë periudhës së stazhit profesional për rreth 11 muaj; dhe detyrën e gjyqtarës së caktuar pas përfundimit të periudhës së gradimit për një periudhë nga data 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, rreth 3 muaj e 20 ditë.

Referuar ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës” që ka qenë në fuqi në kohën përkatëse ka rezultuar se viti i stazhit profesional konsiderohet si pjesë e formimit fillestar dhe gjyqtarët në përfundim të saj vlerësoheshin nga Këshilli Pedagogjik, në bazë të së cilës më pas bëheshin edhe renditja e tyre e cila i përcillej Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas nenit 171, pika 5 e ligjit “Për statusin”, në përfundim të vlerësimit Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur. Siç e relatuar më sipër, ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe është dekretuar si gjyqtare në muajin qershor të vitit 2016 dhe periudha nga ky moment deri në fund të vitit duke e marrë vitin e plotë, është rreth 3 muaj e disa ditë. Referuar ligjit “Për statusin”, parashikohet se magjistratët mund të vlerësohen për një periudhë 3-vjeçare dhe 5-vjeçare në varësi të përvojës profesionale. Në rregulloren përkatëse është parashikuar që vlerësimi mund të bëhet për aq sa është e mundur vetëm kur së paku gjyqtari duhet të ketë një vit përvojë pune.

Që të fillohet procedura e vlerësimit duhet që gjyqtari të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit; Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar; Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret, siç relatuar më sipër, për gjyqtaren {...} kjo periudhë është më e shkurtër se një vit. Për këtë arsye, nga Komisioni përkatës është propozuar që për gjyqtaren të vendoset mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016, pasi koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën dy të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimit t'i njoftohet gjyqtares, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Në projektvendim parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij vendimi si dhe hyrja në fuqi.

Relatoj se gjyqtarja është njoftuar lidhur me këtë relacion. Ka konfirmuar marrjen dijeni dhe nuk ka kërkuar as të marri pjesë dhe as nuk ka paraqitur kundërshtime lidhur me të.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, nëse s'kemi diskutime nga kolegët, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicantaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të njëjtën natyrë, mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën 2013-2016, për gjyqtaren {...}. Sërish relatore është zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Edhe për gjyqtaren {...} është e njëjta situatë, sepse të dyja këto gjyqtare kanë ndjekur Shkollën e Magjistraturës dhe janë dekretuar në të njëjtën periudhë, në të njëjtën datë. Konkretisht pas përfundimit të procesit të vetting-ut nga ana e Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit edhe për këtë gjyqtare është përcjellë dosja përkatëse e rivlerësimit, konkretisht nëpërmjet shkresës me nr. 4380, datë 26.07.2023.

Përpara fillimit të procedurës së vlerësimit janë verifikuar kushtet nga Komisioni përkatës, është verifikuar dokumentacioni me qëllim për të verifikuar kushtet në rast se është e mundur fillimi i procedurës së vlerësimit.

Ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 zonja {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy periudha, konkretisht: në periudhën e stazhit, në vitin 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh; dhe funksionin e gjyqtarit për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë. Por edhe sikur ta marrim vitin e plotë përsëri kjo periudhë është më e vogël se një vit.

Referuar ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës”, viti i tretë praktik konsiderohet pjesë e formimit fillestar dhe në përfundim të saj gjyqtarët vlerësoheshin nga Shkolla e Magjistraturës, në përfundim të të cilës më pas bëhej renditja dhe i përcillej lista Këshillit të Lartë të Drejtësisë në bazën e të cilës bëhej edhe caktimi i tyre në detyrë.

Sipas ligjit “Për statusin”, konkretisht neni 171, pika 5, është parashikuar se Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin e gjyqtarëve, për aq sa është e mundur, pas përfundimit të procesit të vetting-ut.

Në ligjin “Për statusin” janë parashikuar dy mënyra se si bëhet vlerësimi i gjyqtarit, konkretisht për një periudhë trevjeçare dhe pesëvjeçare, në rast se përvoja e gjyqtarit është më e madhe se 15 vjet. Në rastin konkret përvoja e gjyqtares është më pas se 15 vjet dhe bëhet vlerësimi 3-vjeçar. Por në rregullore është parashikuar që bëhet vlerësimi trevjeçar vetëm kur gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka ushtruar jo më pak se një vit detyrën e gjyqtarit.

Në rastin konkret ka rezultuar se edhe për gjyqtaren {...} periudha e ushtrimit të detyrës është, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht edhe të kryerjes së stazhit profesional, është më e vogël se 1 vit.

Për këtë arsye, nga Komisioni propozohet si në rastin e zonjës {...}, mosfillimi i procedurës së vlerësimit për periudhën e gradimin për vitet 2013-2016 për gjyqtaren {...}.

Në pikën e dytë të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për

mosfillimin e procedurës së vlerësimit t'i njoftohet gjyqtarës e cila ka të drejtën të ushtrojë ankimin.

Në pikën e fundit përcaktohet hyrja në fuqi dhe konkretisht me botimin në faqen zyrtare të internetit.

Edhe për zonjën {...}, relacioni përkatës i është njoftuar dhe kjo e fundit ka konfirmuar marrjen dijeni dhe nuk ka paraqitur kundërshtime.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk kemi diskutime nga kolegët.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 503, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}. Për më shumë detaje, sërish fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Me vendimet nr. 499, 502, 503 të vitit 2022 të KLGJ-së, janë hapur procedurat e ngritjes në detyrë respektivisht në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë në

fushën e së drejtës penale dhe në Gjykatën e Apelit Durrës në fushën e së drejtës penale.

Në këto procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë/Durrës, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lirë të shpallur me vendimet si më sipër, ka kandiduar gjyqtari z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Vendimin nr. 66/2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 të vitit 2022, KLGJ vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat që u përmendën më lart. Caktimin e relatorit si më poshtë, për kandidatin z. Hoxha është caktuar si relator z. Klodian Kurushi.

Në vijim të procedurës së verifikimit paraparak të kriterëve të kandidimit për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë, me vendimin nr. 264, datë 24.05.2023, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 499, nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 499 datë 21.11.2022, si dhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022.

Zoti {...}, në vijim të procedurës për verifikimin e pasurisë dhe figurës, me kërkesën e datës 14.06.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr. 3584, datë 21.06.2023, parashtrori kërkesën për heqje dorë nga kandidimi, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se “...paraqes dorëheqjen time nga kandidimi për pozicionin e lirë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Në këto rrethana, sa më sipër, ky relacion bazohet në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75/2019, ku ndërmjet të tjerave përcaktohet se: Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Në përfundim, ne i propozojmë Këshillit që të vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit zotit Hoxha në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503 datë 21.11.2022 për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli, në mungesë, relatohet nga zonja Llagami).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:15 dhe mbaroi në orën 12:02.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicantaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli, në mungesë, relatohet nga zonja Llagami).

Naureda Llagami: Janë tre aktet që duhet t’i bëjmë me dyer të mbyllura, kështu që i lëmë për në fund.

Kalojmë tek projekt-akti që ka të bëjë me shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit.

Ashtu sikurse vepruam në fillim me kualifikimin për emërim, nga ana e Komisionit sillet edhe propozimi për vakancat ku do t’i shpallim këto dy pozicione. Duke parë ngarkesën e gjykatave, kemi vlerësuar se dy gjykata në nevojë janë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata në nevojë,

duke marrë parasysh ngarkesën e madhe të çështjeve që kanë aty dhe duke marrë parasysh strukturën dhe pozicionet vakante që kanë, si dhe kushtet e punës që kanë aty.

Për këtë arsye, ne si Komision vijmë me propozimin që të hapen dy vende vakante për t'iu propozuar kandidateve.

Jemi dakord? Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e propozimit nga ana e Komisionit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Shpalljen e 2 (dy) vendeve vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:

1 (një) në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

1 (një) në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil gjyqësor sipas dispozitave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Me kaq mbaruam çështjet që i kemi me dyer të hapura.

Unë do ftoja të gjithë të pranishmit të largohen për të lejuar Këshillin që të vijojë me shqyrtimin e tre çështjeve të tjera.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor